



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 90, datë 02.08.2022

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.116, DATË 30.09.2021 “PËR DETAJIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.514, DATË 18.09.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO ROMANOS – KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE CAKTIMIN E BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE”

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të ligjit 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet përkatëse, Vendimit nr.775, datë 30.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për Hartimin e Projektpreventivit dhe Riforcimin e Hidrovorit të Durrësit” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.514, datë 18.09.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.512, datë 27.07.2022 “Për një shtesë në

vendimin nr.514, datë 18.09.2021 të Këshillit të Ministrave ”Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”, Udhëzimit nr.2 të Këshillit të Ministrave, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimit nr.3 të Këshillit të Ministrave, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit ” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.116, datë 30.09.2021 “Për detajimin e fondit të përfituar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.514, datë 18.09.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.116, datë 30.09.2021 “Për detajimin e fondit të përfituar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.514, datë 18.09.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”.
2. Miratimin e përdorimit të fondit prej 700.000.000 (shatëqindmilion) lekë pa TVSH të përfituar në zbatim të VKM-së nr.512, datë 27.07.2022 sipas tabelës së mëposhtme :

KAP.	PROGRA MI	Llog.eko n	Kodi I produktit	Kodi institucionit	Emri Institucionit	Emërtimi I projektit	Fondi në lekë VITI 2022
1	04960	231	94902AE	2107001	B.Durres	Rehabilitimi I infrastruktures se rrjetit te kullimitne zonen e Porto romanos-Kenete dhe sistemimin e rrjetit te ujerave te shiut ne zonen urbane te qytetit te durresit	694,000,000.00
1	04960	231	94902AE	2107001	B.Durres	Mbikqyrje	6,000,000.00
			TOTALI				700,000,000.00

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 03.08.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 638/prot.
2

Durrës, më 10.08.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.90 datë 02.08.2022 “Për një shtesë në VKB Nr 116 dt 30.09.2021 “Për detajimin e fondit të përfutur në zbatim të VKM Nr 514 dt 18.09.2021 ”Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

